



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr._____, datë_____._____2023

PËR

**ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E FORCËS REZERVISTE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83, pika 1, dhe 166 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak në rezervë.

Neni 2

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Mobilizimi”** është organizimi i të gjithë apo një pjese të shërbimit ushtarak në rezervë, për të marrë pjesë ose për të siguruar plotësimin e njësive e reparteve të strukturave ushtarake me personel, sipas përcaktimeve në dokumentet strategjike të miratuar me ligj.

2. **“Shërbim ushtarak rezervist”** është pjesë e shërbimit ushtarak dhe kryhet nga shtetasi shqiptar që ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ dhe ai që ka kapërcyer kufijtë e moshës së caktuar për kryerjen e këtij shërbimi, si dhe ushtaraku i nxjerrë në rezervë, sipas kriterëve të ligjit për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
3. **“Njësi ushtarake në rezervë”** është strukturë e Forcave të Armatosura, e organizuar dhe e kompletuar me armatim, pajisje, teknikë, infrastrukturë dhe një minimum personeli aktiv për trajnim dhe mirëmbajtje, e cila aktivizohet dhe kompletohet me personel ushtarak të shërbimit rezervist sipas nevojës.
4. **“Ushtarak në shërbimin në rezervë”** është shtetasi shqiptar që:
 - a) ka shërbyer në Forcat e Armatosura si ushtarak aktiv dhe pasi ndërpret karrierën ushtarake, sipas ligjit përkatës për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përfshihet në strukturat rezervë si oficer, nënoficer dhe ushtar;
 - b) nuk ka shërbyer si ushtarak në Forcat e Armatosura dhe plotëson kushtet dhe kriteret sipas përcaktimeve ligjore dhe pranohet në shërbimin ushtarak në rezervë. Kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin ushtarak në rezervë miratohen nga ministri i Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 3

Qëllimi

Shërbimi ushtarak rezervist shërben për të siguruar individë të trajnuar, me qëllim kompletimin e strukturës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ruajtjen e nivelit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të kërkuar, rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, të nevojshme në rastet e përkeqësimit të gjendjes së sigurisë, si dhe për plotësimin e detyrimeve kombëtare në kuadër të NATO-s, operacionet në përgjigje të krizave, operacionet e mbështetjes së paqes dhe sigurisë rajonale dhe globale, si dhe operacionet e emergjencave civile.

Neni 4

Shërbimi ushtarak rezervist si veprimtari e veçantë

Shërbimi ushtarak rezervist është veprimtari e veçantë, shoqërisht e domosdoshme për shtetin, që kryhet në bazë të dëshirës, vullnetit dhe detyrimit për t'i shërbyer atdheut dhe interesave të kombit, përgjegjësisë për zbatimin e legjislacionit, paanësisë politike, bindjes, profesionalizmit dhe vazhdimësisë së karrierës.

Neni 5

Personeli në shërbimin ushtarak rezervist

1. Numri i personelit që aktivizohen në shërbimin ushtarak rezervist përcaktohet në dokumentet strategjike të miratuara me ligj.
2. Shërbimi ushtarak rezervist organizohet dhe funksionon si pjesë përbërëse e strukturës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Mosha e kryerjes së shërbimit

Shërbimi ushtarak rezervist kryhet nga shtetasit shqiptarë të moshës:

- a) deri 50 vjeç për ushtarë;
- b) deri 55 vjeç për nënoficerë;
- c) deri 60 vjeç për oficerë.

Neni 7

Titullimi dhe gradimi i ushtarakëve në shërbimin ushtarak në rezervë dhe atij rezervist

Shtetasi shqiptar që nuk ka shërbyer më parë në shërbimin ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe që plotëson kriteret e pranimi në shërbimin ushtarak rezervist, titullohet dhe i jepet grada e parë ushtarake që parashikohen në aktet ligjore në fuqi për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura.

Neni 8

Kohëzgjatja dhe kushtet e shërbimit ushtarak rezervist

1. Kohëzgjatja e shërbimit ushtarak rezervist është nga 14 deri në 45 ditë në vit. Për nevoja të stërvitjeve ushtarake, që zgjasin më shumë se 14 deri 45 ditë në vit, ministri i Mbrojtjes urdhëron bashkimin e ditëve të stërvitjes të dy viteve, por jo më shumë se 45 ditë.
2. Koha e shërbimit ushtarak rezervist mund të zgjatet mbi kohën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, vetëm në rastet kur vendosen masat e jashtëzakonshme kur:
 - a) aktivizohet për të marrë pjesë në operacione në kuadrin e vendosjes së masave të jashtëzakonshme dhe për aq kohë sa vazhdon kjo gjendje;
 - b) aktivizohet për të marrë pjesë në operacione apo misione ushtarake ndërkombëtare të drejtuara nga OKB/NATO/BE-ja.
 - c) aktivizohet për të marrë pjesë në operacione apo misione humanitare ndërkombëtare të drejtuara nga BE-ja.
 - ç) aktivizohet për të marrë pjesë në operacione në mbështetje të autoriteteve civile në emergjencat civile.
4. Ushtaraku i shërbimit rezervist nuk ka kufizime territoriale gjatë kryerjes së këtij shërbimi.
5. Shtetasi, me pranimin në shërbimin ushtarak rezervist, nënshkruan kontratën e shërbimit ushtarak ku përcaktohet edhe koha e shërbimi ushtarak rezervist, për një periudhë jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi, por pa kaluar kriteret e qëndrimit në shërbimin ushtarak në rezervë.
6. Ushtarakët që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë dalë në rezervë sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe shtetasit civilë, të cilët plotësojnë kriteret e pranimi në shërbimin ushtarak rezervist, rekrutohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit dhe nënshkruajnë kontratën përkatëse për shërbimin ushtarak në rezervë me kohëzgjatje jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi, por pa kaluar kriteret e qëndrimit në shërbimin ushtarak në rezervë.
7. Ushtarakut të shërbimit rezervist, në fund të periudhës së aktivizimit, duhet t'i bëhet një vlerësim në përputhje me rregulloren e vlerësimit vjetor të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Shtyrja e afatit të kryerjes së shërbimit ushtarak rezervist

Struktura përgjegjëse për rekrutim-mobilizimin ka të drejtë të shtyjë afatin e thirrjes për kryerjen e shërbimit ushtarak rezervist, në rastet kur shtetasi:

- a) del përkohësisht i paaftë për këtë shërbim nga komisioni përkatës mjekësor;
- b) vazhdon studimet në institucionet e arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit;
- c) familja është në gjendje të vështirë ekonomike, por thirrja nuk mund të shtyhet më shumë se 6 muaj në vit;
- ç) kandidon ose zgjidhet në zgjedhjet e përgjithshme ose ato vendore.

Neni 10

Lirimi para kohe nga shërbim ushtarak rezervist

Shtetasi i shërbimit ushtarak rezervist lirohet para kohe nga ky shërbim, në rastet kur:

- a) humbet shtetësinë shqiptare;
- b) dënohet me burgim me vendim të formës së prerë dhe nuk është vendosur pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi;
- c) i jepet masa shumë e rëndë disiplinore “shkarkim dhe lirim nga Forcat e Armatosura” sipas ligjit për disiplinën në Forcat e Armatosura;
- ç) cilësohet i paaftë për vazhdimin e shërbimit ushtarak rezervist, me vendim të komisionit përkatës mjekësor;
- d) për rastet e fatkeqësive familjare dhe kur personat në ngarkim të ushtarakut gjatë kohës së shërbimit në shërbimin ushtarak në rezervë mbeten pa përkujdesje.

Neni 11

Kryerja e shërbimit ushtarak rezervist për shtetasit shqiptar me dy shtetësi

Shtetasit që kanë edhe një shtetësi tjetër, krahas asaj shqiptare, mund të kryejnë shërbimin ushtarak rezervist sipas përcaktimeve të marrëveshjeve dypalëshe mes vendeve përkatëse.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet e ushtarakut në shërbimin rezervist

Të drejtat dhe detyrimet e ushtarakut rezervist, gjatë periudhës së aktivizimit të tij në shërbimin ushtarak rezervist, janë të njëjta me ato të ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura, me përjashtim të të drejtave dhe detyrimeve që ligji ua njeh vetëm ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura.

Neni 13

E drejta e ruajtjes së vendit të punës

1. Shtetasi i cili aktivizohet për kryerjen e shërbimit ushtarak rezervist, ka të drejtën e ruajtjes së vendit të punës.

2. Subjektet shtetërore dhe private janë të detyruara ta rikthejnë në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend tjetër të barasvlershëm.
3. Në rastet e aktivizimit të ushtarakut në shërbimin ushtarak rezervist, subjektit privat i njihet e drejta e kompensimit në masën dhe sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Plotësimi i njësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura

Plotësimi i njësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura me ushtarakë rezervistë bëhet nga struktura përgjegjëse për rekrutim-mobilizimin, sipas kriterëve të përcaktuara me rregullore të veçantë, të miratuar nga ministri i Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

Neni 15

Përfshirjet nga shërbimi ushtarak rezervist

Përfshirjet nga pjesëmarrja në shërbimin ushtarak rezervist shtetasi që kryen detyrat e deputetit, ministrit, prefektit, kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, gjyqtarët, prokurorët, kryetarët e partive politike parlamentare, drejtuesit e institucioneve fetare, përfaqësuesi diplomatik ose konsullor, punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, si dhe shtetasi që ndodhet jashtë shtetit me studime ose për t'u kuruar dhe persona që, nga ministrinë ose institucionet e tjera qendrore, përcaktohen si persona që kanë detyra të rëndësishme, ndërprerja e të cilave cenon sektorët jetikë të vendit.

KREU II

DETYRIMET E AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT USHTARAK NË REZERVË

Neni 16

Autoritetet përgjegjëse për rekrutim-mobilizimin dhe organizimin e shërbimit ushtarak në rezervë

1. Autoritetet përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e shërbimit ushtarak rezervist janë:
 - a) Ministri i Mbrojtjes;
 - b) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura;
 - c) Ministri përgjegjës për shëndetësinë;
 - ç) Ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë;
 - d) Ministri përgjegjës për punët e brendshme;
 - dh) Njësitë e vetëqeverisjes vendore;
 - e) Komandat e forcave dhe ato mbështetëse;
 - ë) Qendra e Personel-Rekrutimit;
 - f) Subjektet shtetërore dhe private.

Neni 17

Ministri i Mbrojtjes

1. Ministri i Mbrojtjes ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) propozon kriteret e titullimit dhe gradimit të ushtarakëve rezervistë;
- b) propozon modelin, normat dhe afatet e përdorimit të uniformës, shenjave dhe simboleve ushtarake që përdoren në shërbimin ushtarak rezervist;
- c) propozon kriteret dhe masën e kompensimit financiar për subjektet private për periudhën e aktivizimit të ushtarakut në shërbimin ushtarak rezervist;;
- ç) miraton, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, rregulloren përkatëse për përcaktimin e kriterëve dhe përgjegjësi të strukturave ushtarake për plotësimin e njësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura me ushtarakë rezervistë;
- d) miraton, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për shëndetësinë, rregulloren e aftësive fizike e shëndetësore të personelit të shërbimit ushtarak rezervist;
- dh) miraton planin vjetor të rekrutimit-mobilizimit të personelit të shërbimit ushtarak rezervist, për zhvillimin e stërvitjeve dhe të veprimtarive të tjera, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
- e) miraton konceptin për organizimin dhe përdorimin e forcës rezerviste, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- ë) miraton rregulloren e përdorimit të uniformave, shenjave dhe simboleve ushtarake që përdoren në shërbimin ushtarak rezervist, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- f) nënshkruan marrëveshje ose kontrata huaje me subjektet private dhe kontrata huapërdorjeje me subjektet publike pronare të tyre, ku përcaktohen detyrimet e palëve;
- g) miraton, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, modelet e dokumentacionit për evidentimin, identifikimin dhe përpunimin e të dhënave të shërbimit ushtarak rezervist që administrohet në Qendrën e Personel-Rekrutimit dhe në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura.

Neni 18

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

1. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) propozon modelin, normat dhe afatet e përdorimit të uniformës, shenjave dhe simboleve ushtarake që përdoren në shërbimin ushtarak rezervist;
 - b) propozon rregulloren e përdorimit të uniformave, shenjave dhe simboleve ushtarake që përdoren në shërbimin ushtarak rezervist;
 - c) propozon konceptin për organizimin dhe përdorimin e forcës rezerviste;
 - ç) propozon planin vjetor të rekrutimit-mobilizimit të personelit të shërbimit ushtarak rezervist, për zhvillimin e stërvitjeve dhe të veprimtarive të tjera;
 - d) propozon planin vjetor të aktivizimit të forcave rezerviste, për zhvillimin e stërvitjeve dhe të veprimtarive të tjera;
 - e) propozon modelet e dokumentacionit për evidentimin, identifikimin dhe përpunimin e të dhënave të shërbimit ushtarak rezervist që administrohet në Qendrën e Personel-Rekrutimit dhe në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura.

Neni 19

Ministri përgjegjës për shëndetësinë

Ministri përgjegjës për shëndetësinë, në bashkëpunim me ministrin e Mbrojtjes, miraton rregulloren e aftësive fizike e shëndetësore të shtetasit dhe ushtarakut në rezervë për efekt të pranimit të tyre në shërbimin ushtarak rezervist.

Neni 20

Ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë

Ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë, nëpërmjet strukturave përkatëse, njofton Qendrën e Personel-Rekrutimit, brenda 15 ditëve nga dita që shtetasi i dënuar me burg dhe është pranuar në shërbimin ushtarak rezervist, dërgohet për të vuajtur dënimin.

Neni 21

Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike

Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, nëpërmjet strukturave përkatëse për gjendjen civile dhe çështjet e kufirit dhe migracionit, njofton ndryshimet në lidhje me të dhënat mbi shtetësinë, gjallërinë, adresat e banimit, si dhe largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë të ushtarakëve të marrë në evidencë për efekt të shërbimit ushtarak rezervist, në Qendrën e Personel-Rekrutimit, brenda 15 ditëve nga dita e dërgimit të kërkesës nga kjo strukturë.

Neni 22

Detyrimet e organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa për lajmërimin e shtetasit që thirret për t'u aktivizuar në shërbimin ushtarak rezervist, sipas listës së dërguar nga Qendra e Personel-Rekrutimit dhe strukturat e tjera ushtarake.

Neni 23

Detyrimet dhe përgjegjësitë e komandave të forcave dhe strukturave mbështetëse

Detyrimet dhe përgjegjësitë e komandave, strukturave mbështetëse dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në funksion të organizimit dhe funksionimit të shërbimit ushtarak rezervist në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga ministri i Mbrojtjes.

Neni 24

Përgjegjësitë e Qendrës së Personel-Rekrutimit

1. Qendra e Personel-Rekrutimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) zbaton planin e rekrutim-mobilizimit, të personelit të shërbimit ushtarak rezervist, për zhvillimin e stërvitjeve dhe të veprimtarive të tjera;
 - b) përgjigjet për sigurimin e personelit të nevojshëm për shërbimin ushtarak rezervist dhe plotësimin e njëjësive dhe reparteve të Forcave të Armatosura me personel rezervist;

- c) përgjigjet për hartimin dhe përditësimin e listës emërore të personelit në shërbimin ushtarak rezervist, brenda muajit janar të çdo viti;
- ç) realizon, në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse, lajmërimin e ushtarakëve të shërbimit ushtarak rezervist, në rast aktivizimi, stërvitje dhe mobilizimi;
- d) nënshkruan kontratat përkatëse me personelin e përzgjedhur për shërbimin ushtarak rezervist;
- dh) propozon te shefi i Shtabit të Përgjithshëm modelet e dokumentacionit për evidentimin, identifikimin dhe përpunimin e të dhënave të shërbimit ushtarak rezervist që administrohet në Qendrën e Personel-Rekrutimit dhe në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura;
- e) ndërpret dhënien e pagesës kalimtare, në rast të refuzimit të ushtarakut rezervist, për deklarimin e të dhënave të kërkuara në evidencën ushtarake.

Neni 25

Subjektet shtetërore dhe private

Subjektet shtetërore dhe private në çdo rast kur njoftohen apo kur u kërkohet nga autoritetet përgjegjëse për shërbimin ushtarak në rezervë në Forcat e Armatosura, janë të detyruar të vënë në dispozicion në afatin dhe periudhën e kërkuar punëmarrësin e tyre, pa krijuar pengesa apo vonesa.

Neni 26

Komisionet mjekësore të kontrollit të aftësive për shërbimin ushtarak në rezervë

1. Për kontrollin e aftësive të shtetasit për pranim në shërbimin ushtarak rezervist, në strukturën mjekësore ushtarake të Forcave të Armatosura krijohet komisioni mjekësor i kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore.
2. Qendra e Personel-Rekrutimit dërgon paraprakisht pranë strukturës mjekësore ushtarake të Forcave të Armatosura, listën e personelit ushtarak që do të kontrollohen për efekt të aktivizimit të tyre në shërbimin ushtarak rezervist.
3. Përbërja e komisioneve, detyrat dhe përgjegjësitë përcaktohen në rregulloren e aftësive fizike e shëndetësore të shtetasit dhe ushtarakut, e cila miratohet bashkërisht nga ministri i Mbrojtjes dhe ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë.

Neni 27

Marrja në evidencë e ushtarakut të shërbimit në rezervë

1. Evidentimi i ushtarakëve në rezervë, si burime njerëzore për kryerjen e detyrimit të shërbimit ushtarak rezervist, realizohen nga Qendra e Personel-Rekrutimit.
2. Ushtarakët në rezervë merren në evidencë me daljen e tyre në rezervë nga shërbimi aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose me pranimin e tyre në shërbimin ushtarak, pas plotësimit të kriterëve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore.

Neni 28

Heqja e shtetasit nga evidenca ushtarake

Ushtaraku i shërbimit në rezervë hiqet nga evidenca ushtarake në rastet kur:

- a) deklarohet i paafte për shërbim ushtarak në rezervë me vendim të komisionit mjekësor;

- b) mbush moshën e përcaktuar sipas nenit 6 të këtij ligji;
- c) lë shtetësinë shqiptare;
- ç) vdes.

Neni 29

Detyrimet e ushtarakut në rezervë dhe rezervist për efekt të evidencës ushtarake

1. Ushtaraku në rezervë, si dhe shtetasi që pranohet rishtas në shërbimin ushtarak rezervist, ka detyrimin të njoftojë Qendrën e Personel-Rekrutimit për të dhënat e tij të kontaktit (adresën e vendbanimit brenda vendit, numrin e telefonit, adresën elektronike, email etj.), fillimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit, si dhe ndryshimet përkatëse.
2. Ushtaraku në rezervë, si dhe shtetasi i cili pranohet rishtas në shërbimin ushtarak rezervist, i cili largohet jashtë shtetit mbi 6 muaj, është i detyruar të njoftojë Qendrën e Personel-Rekrutimit për të bërë shënimet përkatëse në evidencën e shërbimit ushtarak në rezervë.

Neni 30

Detyrimet në rast aktivizimi të ushtarakut të shërbimit në rezervë

1. Ushtaraku në shërbimin në rezervë, i cili ka detyrimin për aktivizim në shërbimin ushtarak rezervist, kur lajmërohet me fletëthirrje për të marrë pjesë në stërvitje, operacion ose mision me marrjen e lajmërimit për mobilizim/aktivizim, detyrohet të paraqitet në Qendrën e Personel-Rekrutimit ose në strukturën ku është caktuar.
2. Ushtaraku në shërbimin në rezervë, në rast të pamundësisë së paraqitjes për arsye të forcës madhore ose fatkeqësive familjare, me të marrë njoftim, vë në dijeni, në vendin e kohën e caktuar, Qendrën e Personel-Rekrutimit ose strukturën ku është caktuar.

Neni 31

Kundërvajtjet administrative

1. Përbën kundërvajtje administrative, në kuptim të këtij ligji, dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 50000 lekë, shmangia e ushtarakut rezervist nga:
 - a) detyrimet në fushën e evidencës ushtarake;
 - b) pjesëmarrja në stërvitje, trajnime dhe operacione të ndryshme ushtarake brenda dhe jashtë vendit.
2. Shmangia nga detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kur kryhet më shumë se 1 herë, përbën kundërvajtje penale, sipas Kodit Penal Ushtarak.
3. Subjektet shtetërore dhe private që nuk përmbushin detyrimet, sipas pikës 2, të nenit 13 dhe nenit 25 të këtij ligji, ndëshkohen me gjobë në masën e 20-fishit të pagës minimale mujore në shkallë vendi.
4. Pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit, për shqyrtimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative, krijohet Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve. Vendimi i komisionit është titull ekzekutiv.

Neni 32

Ekzekutimi i gjobës

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi ndaj vendimeve të komisionit të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimi i tyre bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 33

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të pikës 3, të nenit 13, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë të nxjerrin aktet nënligjor, në zbatim të pikës 3, të nenit 25 të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 34

Aktet nënligjore të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 35

Shfuqizimet

1. Termat “shërbim ushtarak në rezervë” dhe “rezervist”, të përdorur në ligjin nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me përjashtim të pikës 1, germa “c” dhe pikës 2, të nenit 7 të këtij ligji, shfuqizohen.
2. Pika 3, e nenit 9, pikat 2 dhe 3, të nenit 10, nenet 24, 25, pika 3, e nenit 39, të ligjit nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Lindita Nikolli